



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETEROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23 Korrik 2021

Nr: 431

VENDIM

**PËR RIHAPJEN E SHORTIT PËR CAKTIMIN E EKSPERTËVE KONTABËL TË LICENSUAR  
PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA NGA 8 PARTI  
POLITIKE PËR VITIN KALENDARIK 2020**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronja “ë”, dhe pika 2, 21, pika 1, shkronja “b”, si dhe 124/1, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neneve 23/2 dhe 23/3, të ligjit nr. 8580 datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 14 datë 9.6.2021, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore” dhe pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm

**VËREN:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në vlerësim të rëndësisë dhe transparencës së procesit dhe në zbatim të udhëzimit nr. 14 datë 9.6.2021, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”, pas miratimit të listës paraprake të aplikantëve, organizoi më datë 12.7.2021 shortin online ku u përzgjedhën ekspertët kontabël të licensuar (auditues ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2020,

Më datë 23.7.2021 u rihodh shorti për të caktuar ekspertët kontabël të licensuar (auditues ligjor), të cilët do të auditojnë partitë e caktuara në shortin e datës 12.07.2021, me vendimin nr. 425 ekspertës kontabël të licensuar, zj. Fatime Alliu, e cila u tërhoq nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2020.



Ekspertja kontabël e licensuar (audituese ligjore), e cila u tërhoq nga ky proces kishte për të audituar fondet e përfituara dhe shpenzuara nga 8 parti politike, si më poshtë:

- 1) Partia Demokracia Sociale;
- 2) Partia Republikane Shqiptare;
- 3) Partia e Prosperitetit Demokratik të Shqipërisë;
- 4) Partia Ardhmërija Shqiptare;
- 5) Partia Emigracioni Shqiptar;
- 6) Partia Demokracia e Re e Djathtë Shqiptare;
- 7) Partia Aleanca Kombëtare;
- 8) Partia “Sfida për Shqipërinë.

Në 1 (një) enë transparente u vendosën 13 (trembëdhjetë) shirita me emrat e ekspertëve kontabël të licensuar, të cilëve në shortin e datës 12.7.2021, me numër vendimi 425, u ka rënë për të audituar nga 7 (shtatë) parti politike, që pasi u lexuan u futën në gogla me formë, ngjyrë dhe masë të njëjtë, ndërsa në enën tjetër transparente u vendosën 8 (tetë) shirita me emrat e partive politike, të cilat pasi u lexuan u futën në gogla me formë, ngjyrë dhe masë të njëjtë.

Përzgjedhja u bë duke tërhequr nga ena transparente emrin e ekspertit kontabël të licensuar dhe duke tërhequr nga ena tjetër transparente emrin e partisë politike.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Referuar neneve 19, pika 1, shkronja “ë”, dhe pika 2, 21, pika 1, shkronja “b”, si dhe 124/1, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neneve 23/2 dhe 23/3, të ligjit nr. 8580 datë 17.2.2000, “ Për partitë politike”, i ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 14 datë 9.6.2021, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”,

### **V E N D O S:**

1. Të miratojë rezultatin e rihedhjes së shortit për caktimin e 8 (tetë) partive politike ekspertëve kontabël të licensuar, si më poshtë:
  - 1) **Margarita Kalemasi (i shtohet)**
    - a. Partia Demokracia Sociale.
  - 2) **Hidajete Kraja (i shtohet)**
    - a. Partia Republikane e Shqipërisë.



**3) Silvana Gjikhima (i shtohet)**

- a. Partia e Prosperitetit Demokratik të Shqipërisë.

**4) Fatmira (Sykja) Kastrati (i shtohet)**

- a. Partia Ardhmërija Shqiptare.

**5) Ludmilla Paluka (i shtohet)**

- a. Partia Emigracioni Shqiptar.

**6) Eneida Rahmani (i shtohet)**

- a. Partia Demokracia e Re e Djathtë Shqiptare.

**7) Aida Maloku (i shtohet)**

- a. Partia Aleanca Kombëtare.

**8) Anida Nuri (i shtohet)**

- a. Partia “Sfida për Shqipërinë”

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Ilirjan CELIBASHI**

